



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 14, dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, si dhe neneve 17, 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, duke u bazuar në Kërkesën e Drejtorit të Drejtoratit për Administratë 1-353-14776 të datës 15.03.2021 dhe Pëlqimit Nr-2-030-14072 të datës 11.03.2021 të lëshuar nga Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryetari i Komunës merr

VENDIM  
PËR ZHVENDOSJEN E ZYRËS SË GJENDJES CIVILE NË MAGURË

I. Me këtë Vendim, ZHVENDOSJET, Zyra e gjendjes civile në fshatin Magurë nga lokacioni aktual tek zyra e cila gjendet në kuadër të pjesës hyrëse të hapësirës së Objektivit të Qendrës Rinore Rekreative në Magurë me të gjithë dokumentacionin dhe paisjet teknologjike që i ka në posedim.

II. Për procedurën e zhvendosjes nga zyra aktuale deri te zyra në kuadër të objektivit të Qendrës Rinore Rekreative në Magurë do të mbahet procesverbal të cilin do mbaj zyrtari i caktuar nga ana e Drejtorit të Drejtoratit për Administratë.

III. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtori për Administratë.

**Arsyetim**

Zhvendosja e Zyres së Gjendjes civile nga lokacioni aktual te zyra e cila gjendet në kuadër të pjesës hyrëse të hapësirës së Objektivit të Qendrës Rinore Rekreative në Magurë bëhet përshkak se zyra aktuale nuk i plotëson kushtet teknike për mbarëvajtjen e rregullt të punës.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi

Vendimi i dërgohet:  
Drejtoratit për Administratë  
Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport

1Nr.353-14776  
Lipjan, më 16.03.2021

KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti

